



Prishtinë, 28 mars 2019
Kodi i ZRRE: V_1126_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 Nenit 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 27 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së);
- Vendimin e ZRRE-së nr. V_1027_2018, lidhur me të hyrat e lejuara maksimale për periudhën e dytë rregullative 2018-2022, për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
- Aplikacionin e Operatorit Sistemit të Shpërndarjes - OSSH (KEDS Sh.A.) për të Hyrat e Lejuara Maksimale, të dorëzuar me datën 21 janar 2019 në ZRRE;

në seancën e mbajtur më 28 mars 2019 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (HLM në tekstin e mëtejme MAR)** që do të mbulohen nga Operatori i Licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) KEDS SH.A., përmes tarifave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes për vitin relevant tarifar 1 prill 2019 - 31 mars 2020.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga OSSH-ja për vitin relevant tarifar 1 prill 2019- 31 mars 2020 do të jenë **101,504,643** euro.
- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës për Të Hyrat e OSSH-së, të nxjerr nga ZRRE.
- IV. Operator i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) duhet t'i përgatis dhe dorëzoj për aprovim në ZRRE tarifat për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes të përcaktuar me MAR-in sipas këtij Vendimi.
- V. Tarifat e propozuara nga OSSH/KEDS duhet të jenë në përputhje me Metodologjinë e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Metodologjinë e Taksave për Kçje në OSSH, të aprovuar nga ZRRE.

A R S Y E T I M


- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 08 dhjetor 2018 ka iniciuar azhurnimet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH.
- ZRRE me datë 21 janar 2019 nga KEDS SH.A. ka pranuar aplikacionin për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale.
- ZRRE me rastin e përcaktimit për të Hyrat e Lejuara Maksimale ka marrë parasysh dokumentet që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së :
 - Raport Konsultativ - Përshatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KEDS (prill 2019 - mars 2020), i publikuar më 22 shkurt 2019; dhe
 - Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së, Përgjigjet ndaj Komenteve (prill 2019 - mars 2020).
- Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

VI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) duke filluar nga data 1 prill 2019, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Kompania Kosovare për Shpërndarje dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS/OSSH), dhe
- Arkivit të ZRRE-së.